

K O N V E N T Ë

MIDIS REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS POPULLORE RUMUNE MBI DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE PËR ÇESHTJE CIVILE, FAMILJARE DHE PENALE

Presidiumi i Kuvëndit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Presidiumi i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Republikës Popullore Rumune,

Duke dashur të forcojnë marrëdhëniet vëllazërore midis të dy vëndeve dhe popujve të tyre dhe të zhvillojnë në fushën e bashkëpunimit marrëdhëniet juridike midis të dy vëndeve, vendosen të lidhin një konventë mbi dhënie e ndihmës juridike në çështje civile, familjare dhe penale dhe për këtë qëllim, emruan të plotfuqishmit e tyre:

Presidiumi i Kuvëndit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë Riza Taushanin, zëvendësministër i Drejtësisë,

Presidiumi i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Republikës Popullore Rumune Gjeorgje Vellçesku, ambasador i Jashtëzakonëshëm dhe fuqiplot i Republikës Popullore Rumune në Republikën Popullore të Shqipërisë,

të cilët pas çkëmbimit të plotfuqive të tyre, që u gjetën në formë të duhur dhe të plotë, u muarrën vesh për sa vijon:

PJESA I

Dispozita të përgjithëshme

Neni 1.

Mbrojtja juridike

1/ Shtetasit e njerës Palë Kontraktuese dhe personat juridike të sajë, të krijuara sipas ligjes të kësaj Pale (që me tutje do quhen "shtetas") për sa u përket të drejtave të tyre personale dhe pasurore, gëzojnë në teritorin e Palës tjetër kontraktuese, po atë mbrojtje juridike sikundër edhe shtetasit dhe personat juridike të kësaj Pale Kontraktuese.

2/ Shtetasit e një Pale Kontraktuese, kanë të drejtë t'u drejtohen lirisht dhe pa pengesa gjykatave, prokurorisë, zyrave të noterisë (që me tutje do të quhen "institucione të drejtësisë") dhe institucioneve të tjera të Palës tjetër Kontraktuese, në kompetencën e të cilëve hyjnë çështjet civile, familjare dhe penale, të marrin pjesë në 'to, sidhe t'u drejtojnë kërkesa dhe të ngrejné padi po në ato kushte sidhe shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 2.

Dhënia e ndihmës juridike

1/ Institucionet e drejtësisë të të dy Palëve Kontraktuese u japin ndihmë juridike njeri tjetrit për çështjet civile, familjare dhe penale.

2/ Institucionet e drejtësisë të të dy Palëve Kontraktuese u japin ndihmë juridike edhe institucioneve të tjera, në kompetencën e të cilëve hyjnë çështjet që përmenden në paragrafin e parë.

Neni 3.

Mënyra e komunikimit

1/ Në dhënien e ndihmës juridike, institucionet e drejtësisë të Palëve Kontraktuese komunikojnë midis tyre nëpërmjet organeve të tyre qëndrore, përderisa nuk parashikohet ndryshe nga kjo konventë,

2/ Institucionet e tjera, në kompetencën e të cilëve janë çështjet civile ose familjare, komunikojnë me institucionet e drejtësisë të Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 4.

Përmbajtja e ndihmës juridike

Palët Kontraktuese u japin njera tjetrës ndihmë juridike me anë të kryerjes së veprimeve proceduriale si: përpillimi, dërgimi dhe dorëzimi i dokumentave, dërgimi ose dorëzimi i provave materiale, bërja e ekspertimeve dhe kqyrjeve në vënd, pyetja e palëve, të pandehurve, pyetja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të tjerë, bërja e kontrollimeve dhe sekuestrimeve, sidhe e veprimtarive të tjera të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 5.

Gjuha e përdorur në dhënien e ndihmës juridike

1/ Institucionet e drejtësisë dhe institucionet e tjera të Palëve Kontraktuese përdorin, në marrëdhëniet midis tyre, gjuhën e vet ose gjuhën ruse.

2/ Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike sidhe dokumentat që i bashkëngjiten, duhet të jenë të përpilluara në gjuhën e Palës Kontraktuese që ka bërë porosinë të shoqëruara me përkthim të vërtetuar në gjuhën e Palës Kontraktuese secilës i është drejtuar porosia.

3/ Pala Kontraktuese secilës i është drejtuar porosia, i kryen veprimet në lidhje me kërkesën e dhënies së ndihmës juridike, në gjuhën e vet.

Neni 6.

Përmbajtja e porosisë në dhënien e ndihmës juridike
Kërkesa për dhënie ndihmë juridike duhet të përmbajë këto të
dhëna:

- a) emërtimin e institucionit që bën porosinë;
- b) emërtimin e institucionit që i drejtohet porosia;
- c) tregimin e çështjes për të cilën kërkohet ndihma juridike;
- ç) emërin dhe mbiemërin e palëve, të të pandehurve ose të të denuarve, shtetësinë e tyre, profesionin, vendbanimin ose vendqëndrimin e tyre, dhe, në rast se kanë përfaqësues, emërat dhe mbiemërat sidhe adresën e tyre;
- d) të dhënat e nevojëshme mbi thelbin e porosisë, dhe, për çështjet penale, përshkrimin e krimit.

Neni 7.

Mënyra e kryerjes së porosisë

1/ Në kryerjen e porosisë për dhënien e ndihmës juridike, institucioni të cilit i është drejtuar porosia, zbaton legjislacionin e shtetit të tij. Por me kërkesën e institucionit që bën porosinë ai mund të zbatojë normat proceduriale të Palës Kontraktuese që bën porosinë, në qoft se ato nuk vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shtetit të tij.

2/ Kur institucioni të cilit i drejtohet porosia nuk është kompetent për kryerjen e porosisë, atëhere ai ia dërgon kryesisht porosinë institucionit kompetent, dhe njofton për këtë, institucionin që ka bërë kërkesën.

3/ Me kërkesën e institucionit i cili ka bërë porosinë, institucioni të cilit i është drejtuar kjo, njofton me kohë atë për datën dhe vëndin e kryerjes së porosisë.

4/ Pas kryerjes së porosisë, institucioni të cilit i është drejtuar porosia, ia këthen dokumentat institucionit që ka bërë porosinë. Kur ndihma juridike nuk mund të jepet, institucioni të cilit i është drejtuar porosia, ia këthen dokumentat institucionit që ka bërë porosinë, duke i njoftuar njikohësisht rrethanat që kanë penguar kryerjen e porosisë.

Neni 8.

Forma e dokumentave

Dokumentat që dërgohen në bazë të kësaj Konvente, duhet të

kenë nënshkrimin dhe vulën zyrtare.

Neni 9.

Paprekëshmëria e dëshmitarëve dhe eksperteve

1/ Dëshmitari ose eksperti që paraqitet në institucionet e drejtësisë të Palës Kontraktuese e cila ka bërë porosinë, me ftesë të dorëzuar atij nga institucioni i Palës Kontraktuese që i është drejtuar porosia, pavarësisht nga shtetësia e tij, nuk mund t'i nënshtrohet ekzekutimit të një denimi, ndjekjes ose arrestimit, qoftë për vepra penalisht të denueshme që përbëjnë objektin në shqyrtim, qoftë për ndonjë vepër tjetër që dënohet penalisht, të kryer para se të kalonte kufirin e shtetit që ka bërë porosinë, as të denohen, gjithashtu, për vepra të tilla në territorin e Palës Kontraktuese që ka bërë porosinë.

2/ Dëshmitari ose eksperti humbet këtë garanci në qoft se nuk e len territorin e Palës Kontraktuese që ka bërë porosinë brënda një jave nga dita kur institucioni që ka bërë porosinë, e njofton atë se prania e mëtejshme e tij nuk është e nevojëshme më. Në këtë afat nuk llogaritet koha gjatë secilës dëshmitari ose eksperti, pa faj, nuk ka mundur të lerë territorin e Palës Kontraktuese që ka bërë porosinë.

Neni 10.

Dorëzimi i dokumentave

1/ Institucioni të cilit i drejtohet porosia, dorëzon dokumentat në përputhje me rregullat që janë në fuqi në vëndin e tij, në qoftë se dokumenti që dorëzohet është përpilluar në gjuhën e tij ose atij i është bashkëngjitur përkthimi i vërtetuar. Në raste të tjera institucioni të cilit i drejtohet porosia, i a dorëzon këtë dokument marrësit, kur ky i fundit e pranon atë vullnetarisht.

2/ Vërtetimin e përkthimit e bën përkthyesi zyrtar ose institucioni që ka bërë porosinë, ose përkthyesi i caktuar prej tij sipas ligjës, ose përfaqësuesi diplomatik ose konsullor i njerës nga Palët Kontraktuese.

3/ Në porosinë për dorëzimin e dokumentave duhet të shënohen adresa e përpiktë e marrësit dhe tregimi i dokumentave që duhet të dorëzohen.

4/ Kur dokumentat nuk mund të dorëzohen në adresën që tregohet në porosinë, institucioni të cilit i drejtohet porosia, me inisiativën e tij, duhet të marrë masat e nevojëshme për të gjetur adresën; kur gjetja e adresës nga institucioni të cilit i është drejtuar poro-

sia, është e pamundur, ai njofton për këtë institucionin që ka bërë porosinë dhe i kthen këtij dokumentat që duhet të dorëzoheshin.

Neni 11.

Vërtetimi i dorëzimit

Vërtetimi i dorëzimit të dokumentave bëhet në përputhje me dispozitat mbi dorëzimin e dokumentave të Palës Kontraktuese së cilës i drejtohet porosia.

Neni 12.

Dorëzimi i dokumentave shtetasve të vet

Palët Kontraktuese kanë të drejtë t'u dorëzojnë dokumentat shtetasve të tyre, kur këta i pranojnë, nëpërmjet përfaqësive të tyre diplomatike ose konsullore.

Neni 13.

Njohja e dokumentave

1/ Dokumentat e përpilluara ose të vërtetuara në formën përkatëse nga organi kompetent shtetëror, ose nga personi zyrtar dhe të pajisura me vulë me stemë në teritorin e njerës Palë Kontraktuese, pranohen në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese pa ndonjë vërtetim tjetër. Po kështu veprohet edhe për nënëshkrimet e vërtetuara simbas dispozitave të njerës nga Palët Kontraktuese.

2/ Dokumentat, të cilat në teritorin e njerës nga Palët Kontraktuese quhen si dokumenta zyrtare, kanë fuqinë provuese të dokumentave zyrtare edhe në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 14.

Shpenzimet lidhur me dhënien e ndihmës juridike

1/ Pala Kontraktuese së cilës i është drejtuar porosia, nuk kërkon pagimin e shpenzimeve të bëra për dhënien e ndihmës juridike. Palët Kontraktuese marrin përsipër të gjitha shpenzimet lidhur me dhënien e ndihmës juridike në teritoret e tyre, sidhe shpenzimet lidhur me marrjen e provave.

2/ Institucioni të cilit i është drejtuar porosia, i njofton institucionit që ka bërë porosinë shumën e shpenzimeve. Në qoftë se institucioni që ka bërë porosinë do të marrë këto shpenzime nga personi që detyrohet t'i paguajë ato, këto i mbeten Palës Kontraktuese institucioni i së cilës i ka nxjerë.

Neni 15.

Refuzimi i dhënies së ndihmës juridike

Ndihma juridike mund të refuzohet kur dhënia e saj mund të

dëmtojë rendin shoqëror dhe ekonomik të Palës Kontraktuese së cilës i është drejtuar porosia.

Neni 16.

Njoftime mbi çështjet juridike

Ministritë e Drejtësisë të Palëve Kontraktuese u japin njera tjetrës njoftime mbi çështjet juridike.

PJESA II

Dispozita të posaçme

KAPITULLI I

Ndihma juridike në çështjet civile dhe familjare

Nënkapitulli I

Shpenzimet gjyqësore

Neni 17.

Çkarkimi nga sigurimi i shpenzimeve gjyqësore

Shtetasve të një Pale Kontraktuese që marrin pjesë në gjykatat e Palës tjetër Kontraktuese dhe banojnë në teritorin e njerës nga Palët Kontraktuese, nuk mund t'u ngarkohet detyrimi për të siguruar shpenzimet gjyqësore vetëm për shkak se ata janë të huaj ose nuk kanë vendbanim ose vendqëndrim të përherëshëm, ose qendrën e veprimtarisë në teritorin e Palës së cilës i përket gjykata.

Çkarkimi nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore

Neni 18.

Shtetasit e njerës Palë Kontraktuese çkarkohen në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore, dhe kanë të drejtë për ndihmë juridike falas po në atë vëllim dhe po në ato kushte si edhe shtetasit e vet. Çkarkimi nga shpenzimet përfshin të gjitha veprimet proceduriale sidhe ato të ekzekutimit.

Neni 19.

1/ Dokumentat mbi gjëndjen personale sidhe familjare, mbi të ardhurat dhe pasurinë, që nevojiten për t'u përjashtuar nga pagimi i taksës dhe shpenzimeve gjyqësore, lëshohen nga institucionet kompetente të Palës Kontraktuese, në teritorin e së cilës personi i interesuar ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij.

2/ Në qoftë se personi i interesuar nuk ka vendbanimin ose vendqëndrimin në asnjë nga teritoret e Palëve Kontraktuese, është i mjaftueshëm dokumenti që lëshohet ose vërtetohet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore e shtetit të tij.

./..

3/ Institucioni që jep vendimin në bazë të kërkesës të interesuarit mbi përjashtimin nga pagimi i taksës dhe shpenzimeve gjyqësore, mund të kërkojë shpjegime plotësuese.

Neni 20.

Shtetasi i njerës Palë Kontraktuese, që dëshëron t'i bëjë kërkesë institucionit të Palës tjetër Kontraktuese mbi përjashtimin nga pagimi i taksës dhe i shpenzimeve gjyqësore, sidhe mbi pjesmarrjen e avokatit në zhvillimin e proçesit, mund t'ia parashtrojë këtë kërkesë gjykatës kompetente të vendbanimit ose vendqëndrimit të tij. Kërkesa për përjashtim nga taksa dhe shpenzime gjyqësore e bërë sipas ligjës, i dërgohet së bashku me dokumentat që përmënden në paragrafin e I-rë të nenit 19 sidhe me dokumentat e tjera të paraqitura nga personi i interesuar, gjykatës kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

Nënkapitulli II

Statuti personal dhe e drejta familjare

Neni 21.

Zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar

Zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar e një personi përcaktohen nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës është ai.

Neni 22.

Lidhja e martesës

1/ Kushtet që kërkohen për secilin bashkëshort të ardhëshëm për lidhjen e martesës, përcaktohen nga legjislacioni i Palës Kontraktuese shtetas i së cilës është ky bashkëshort i ardhëshëm. Në kushtet që kërkohen për lidhjen e martesës hyn edhe autorizimi i institucioneve shtetërore kompetente, kur një autorizim i tillë parashikohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese shtetas i së cilës është bashkëshorti i ardhëshëm.

2/ Forma e lidhjes së martesës përcaktohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, në teritorin e së cilës bëhet lidhja e martesës.

3/ Forma e lidhjes së martesës, që zbatohet nga përfaqësuesi diplomatik ose konsullor i autorizuar, përcaktohet nga legjislacioni i vëndit të përfaqësisë diplomatike ose konsullore.

Neni 23.

Marrëdhëniet juridike personale dhe pasurore të bashkëshortëve

1/ Marrëdhëniet juridike personale dhe pasurore të bash-

këshortëve, përcaktohen nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktuese, shtetas i së cilës janë ata.

2/ Kur njeri nga bashkëshortët është shtetas i njerës Palë Kontraktuese dhe tjetri është shtetas i Palës tjetër Kontraktuese, marrëdhëniet e tyre juridike personale dhe pasurore përcaktohen nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktuese, në territorin e së cilës ata kanë ose kanë patur kohën e fundit vendbanimin e tyre të përbashkët.

Neni 24.

Zgjidhja e martesës me çkurorëzim

1/ Për zgjidhjen e martesës janë kompetente gjykatat e Palës Kontraktuese shtetas të së cilës janë bashkëshortët; kur bashkëshortët kanë vendbanimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kompetente janë gjithashtu edhe gjykatat e kësaj Pale Kontraktuese, të cilat zbatojnë legjislacionin e Palës Kontraktuese, shtetas të së cilës janë bashkëshortët.

2/ Kur në kohën e ngritjes së padisë për zgjidhjen e martesës njeri nga bashkëshortët është shtetas i njerës Palë Kontraktuese dhe tjetri i Palës tjetër Kontraktuese, kompetente janë gjykatat e asaj Pale Kontraktuese në territorin e së cilës bashkëshortët kanë vendbanimin e tyre, dhe kur njeri banon në territorin e njerës dhe tjetri në territorin e tjetrës Palë Kontraktuese, kompetente janë gjykatat e të dy Palëve Kontraktuese. Gjykatat në çdo rast zbatojnë legjislacionin e shtetit të tyre.

Neni 25.

Deklarimi i martesës si të pavlefshme

Dispozitat e nenit 24 zbatohen edhe për deklarin e martesës si të pavlefshme.

Marrëdhënie juridike midis prindërve dhe fëmijve.

Neni 26.

1/ Marrëdhëniet juridike midis prindërve dhe fëmijve rregullohen nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës është fëmija.

2/ Çështjet në lidhje me kundërshtimin dhe vërtetimin e atësisë dhe amesisë zgjidhen në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese, shtetas të së cilës është fëmija.

Neni 27.

1/ Për marrjen e vendimeve lidhur me marrëdhëniet juridike të përmendura në nenin 26, janë kompetente gjykatat e asaj Pale Kon-

traktuese, shtetas të sëcilës është fëmija.

2/ Kur paditësi dhe i padituri banojnë në teritorin e njerës nga Palët Kontraktuese, atëhere kompetente janë edhe gjykatat e kësaj Pale, por duke respektuar dispozitat e nenit 26.

Neni 28.

Deklarimi i çdukjes, i vdekjes dhe konstatimi i faktit të vdekjes

1/ Për çështjet e deklaramit, të çdukjes ose të vdekjes së një personi ose të konstatimit të kohës së vdekjes, konstatimi i faktit të vdekjes, kompetente janë institucionet e asaj Pale Kontraktuese shtetas i sëcilës ka qenë personi në atë kohë kur ishte i gjallë sipas të dhënave të fundit.

2/ Institucionet e njerës Palë Kontraktuese mund të shpallin shtetasin e Palës tjetër Kontraktuese të çdukur ose të vdekur sidhe të konstatojnë kohën e vdekjes, të konstatojnë faktin e vdekjes së tij kur:

a) kërkesa bëhet nga një person që banon në teritorin e Palës Kontraktuese, institucionit të sëcilës i paraqitet kërkesa dhe që sipas ligjës të kësaj Pale, është kompetente ta shqyrtojë;

b) i çdukuri vendbanimin e tij të fundit e ka patur në teritorin e Palës Kontraktuese, institucionit të sëcilës i paraqitet kërkesa.

3/ Në rastet e parashikuara në paragrafet 1 dhe 2 të sipërme institucionet e Palëve Kontraktuese zbatojnë legjislacionin e shtetit të tyre.

Tutoria dhe kujdestaria

Neni 29.

1/ Për çështjet e tutorisë dhe kujdestarisë ndaj shtetasve të Palëve Kontraktuese, kur Konventa nuk parashikon ndryshe, kompetente janë institucionet e kujdestarisë së Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës është personi që vihet nënë tutori ose kujdestari.

2/ Rastet dhe kushtet për vënien nënë tutori ose kujdestari sidhe për heqien nga tutoria dhe kujdestaria, rregullohen nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, shtetas i sëcilës është personi që vihet nënë tutori ose kujdestari.

3/ Marrëdhëniet juridike midis tutorit ose kujdestarit dhe personit të vënë nënë tutori ose kujdestari, rregullohen nga legjislacioni i Palës Kontraktuese institucioni i kujdestarisë të sëcilës ka

caktuar tutorin ose kujdestarin.

4/ Në lidhje me detyrimin e pranimin të tutorisë ose kujdestarisë zbatohet legjislacioni i Palës Kontraktuese, shtetas i sëcilës është personi që caktohet tutor ose kujdestar.

Neni 30.

1/ Kur marrjen e masave në lidhje me tutorinë ose kujdestarinë e kërkojnë interesat e personit të vënë nënë tutori ose nënë kujdestari, vendbanimi ose vendqëndrimi, ose pasuria e të cilit ndodhet në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese, institucioni i kujdestarisë i kësaj Pale Kontraktuese duhet t'ia njoftojë menjëherë institucionit të kujdestarisë të Palës tjetër Kontraktuese që është kompetent në bazë të paragrafit 1 të nenit 29.

2/ Në raste të ngutëshme, institucioni i kujdestarisë i Palës tjetër Kontraktuese mund të marrë edhe vetë masat e nevojshme, por ai duhet të njoftojë menjëherë mbi masat paraprake që ka marrë, organin e kujdestarisë që është kompetent në bazë të paragrafit 1 të nenit 29. Masat e marra mbeten në fuqi gjersa ky institucion i kujdestarisë të marrë ndonjë vendim tjetër.

Neni 31.

1/ Kur vendbanimi ose vendqëndrimi ose pasuria e personit që është nënë tutori ose kujdestari ndodhet në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese, institucioni i kujdestarisë i cili është kompetent në bazë të paragrafit 1 të nenit 29 mund t'ua kalojë kompetencat lidhur me tutorinë ose kujdestarinë institucioneve të Palës tjetër Kontraktuese. Kalimi është i vlefshëm vetëm në ato raste kur institucioni i kujdestarisë të cilit i bëhet kërkesë pranon detyrën e tutorisë ose kujdestarisë dhe për këtë njofton institucionin e kujdestarisë që ka bërë kërkesën.

2/ Institucioni i kujdestarisë i Palës tjetër Kontraktuese, që është kompetent sipas paragrafit të 1 ushtron tutorinë dhe kujdestarinë në përputhje me legjislacionin e shtetit të tij. Por ai duhet të zbatojë legjislacionin e Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës është personi i vënë nënë tutori ose kujdestari, për sa i përket zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar të personit të vënë nënë tutori ose kujdestari. Ai nuk ka të drejtë të japë vendime për çështje që kanë të bëjnë me statutin personal të personit që është nënë tutori ose kujdestari.

Neni 32.

Adoptimi

1/ Adoptimi ose pushimi (konstatimi ose deklarimi i pavlefshmërisë) i tij regullohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës është adoptuesi në kohën e adoptimit ose të pushimit të adoptimit (konstatimit ose deklarimit të pavlefshmërisë).

2/ Kur fëmija është shtetas i Palës tjetër Kontraktuese, për adoptimin ose pushimin (konstatimin ose deklarimin e pavlefshmërisë) e adoptimit duhet të meret pëlqimi i fëmijës, i përfaqësuesit ligjor të tij dhe i institucioneve shtetërore kompetente të kësaj Pale Kontraktuese, në qoftë se kjo kërkohet nga ligja e shtetit shtetas i të cilit është fëmija.

3/ Kur fëmija adoptohet nga bashkëshortë, njeri prej të cilëve është shtetas i njerës nga Palët Kontraktuese dhe tjetri shtetas i Palës tjetër Kontraktuese, adoptimi ose pushimi (konstatimi ose deklarimi i pavlefshmërisë) i tij bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të të dy Palëve Kontraktuese.

4/ Për çështjet e adoptimit ose pushimit (konstatimit ose deklarimit të pavlefshmërisë) të tij, kompetente janë institucionet e Palës Kontraktuese shtetas i së cilës është adoptuesi në çastin e adoptimit ose të pushimit (konstatimit ose deklarimit të pavlefshmërisë) të tij. Për rastin e parashikuar në pikën 3 kompetent është institucioni në rrethin e veprimtarisë të të cilit bashkëshortët kanë ose kanë patur në kohën e fundit vendbanimin e tyre të përbashkët.

Nënkapitulli III

Dërgimi i vërtetimeve mbi gjëndjen civile dhe i dokumentave të tjera

Neni 33.

Palët Kontraktuese i dërgojnë, mbi kërkesën, njera tjetrës, nëpërmjet organeve të tyre qëndrore, vërtetimet mbi gjëndjen civile, dokumentat mbi arësimin dhe vjetërsinë në punë që u përkasin shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese. Në kërkesë tregohen të dhënat e nevojshme. Dokumentat përpillohen në gjuhën e Palës Kontraktuese së cilës i është drejtuar kërkesa dhe dërgohen falas.

Nënkapitulli IV.

Dispozita mbi çështjet e trashëgimisë

Neni 34.

Parimi i barazisë së të drejtave

Shtetasit e njerës Palë Kontraktuese barazohen në të drejtat me shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese, që banojnë në territorin e saj përsa i përket zotësisë për të bërë dhe revokuar testament për pasurinë që gjëndet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ose për të drejta që duhet të ushtrohen atje, sidhe përsa i përket zotësisë për të fituar me trashëgimi pasuri ose të drejta. Pasuria ose të drejtat kalojnë tek ata po në ato kushte që janë caktuar për shtetasit e Palës Kontraktuese, që banojnë në territorin e saj.

Neni 35.

E drejta e trashëgimisë

1/ Trashëgimia mbi pasurinë e luejtëshme regullohet nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktuese shtetas i së cilës ka qenë trashëgimlënësi në kohën e vdekjes së tij.

2/ Trashëgimia mbi pasurinë e paluejtëshme regullohet nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktuese, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

Neni 36.

Testamenti

1/ Zotësia për të bërë ose revokuar testament sidhe pasojat juridike të të metave në çfaqjen e vullnetit, përcaktohen nga legjislacioni i Palës Kontraktuese shtetas i së cilës ka qenë trashëgimlënësi në kohën e çfaqjes së vullnetit. Po nga ky legjislacion përcaktohen edhe llojet e testamenteve që lejohen.

2/ Forma e bërjes dhe revokimit të testamenteve përcaktohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës trashëgimlënësi ka qenë në kohën që është bërë ose revokuar testamenti, ose nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës është bërë ose revokuar testamenti.

Neni 37.

Kompetenca në çështjet e trashëgimisë

1/ Çështjet në lidhje me trashëgiminë e pasurisë së luejtëshme, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, shqyrtohen nga institucionet e Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës ka qenë trashëgimlënësi në kohën e vdekjes.

2/ Çështjet në lidhje me trashëgiminë e pasurisë së paluejtëshme shqyrtohen nga institucionet e Palës Kontraktuese në territorin e sëcilës ndodhet kjo pasuri.

3/ Dispozitat e pikës 1 dhe 2 zbatohen përkatësisht edhe për konfliktet që lindin në bazë të së drejtës së trashëgimisë.

4/ Kur e gjithë pasuria e luejtëshme e trashëguar, që mbetet mbas vdekjes së shtetasit të njerës nga Palët Kontraktuese, ndodhet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe janë dakord të gjithë trashëgimtarët, atëhere me kërkesën e trashëgimtarit proçedimi bëhet nga organet e kësaj Pale Kontraktuese.

Neni 38.

Njoftimi për vdekje

1/ Kur shtetasi i njerës Palë Kontraktuese vdes në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, institucioni përkatës duhet të lajmërojë menjëherë për vdekjen përfaqësinë diplomatike ose konsullore të shtetit, shtetas i të cilit ka qenë i vdekuri, dhe të njoftojë gjithëcka që di për trashëgimtarët, për vendbanimin ose vendqëndrimin ose adresën e tyre, për gjëndjen e trashëgimit sidhe për faktin nëse ka testament.

2/ Në qoftëse përfaqësia diplomatike ose konsullore mer njoftim për vdekjen më parë, ajo është e detyruar të vërë në dijeni për këtë institucionin e drejtësisë që është kompetent për marrjen e masave në lidhje me ruajtjen e trashëgimit.

Neni 39.

Të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore në çështjet trashëgimore

1/ Në të gjitha çështjet në lidhje me trashëgiminë, që lindin në territorin e njerës nga Palët Kontraktuese, përfaqësia diplomatike ose konsullore e Palës tjetër Kontraktuese ka të drejtë të përfaqësojë para institucioneve të Palës Kontraktuese interesat e shtetasve të shtetit të vet kur ata nuk marrin pjesë në proçedim dhe nuk kanë caktuar përfaqësuesit e tyre, në këto raste nuk kërkohet ndonjë prokurë e veçantë.

2/ Kur shtetasi i njerës Palë Kontraktuese vdes gjatë udhëtimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ku ai nuk ka patur vendbanimin ose vendqëndrimin e përherëshëm, sendet që ai kishte me

vehte i dorëzohen përfaqësisë diplomatike ose konsullore të shtetit shtetas i të cilit ka qenë ai, pa ndonjë formalitet.

Neni 40.

Çelja e testamentit

Testamenti çelet nga institucionet kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e sëcilës ndodhet testamenti. Kopja e vërtetuar e testamentit dhe kopja e procesverbalit të vërtetimit dhe të çeljes së testamentit dhe, në rast nevoje, dhe origjinali i testamentit, i dërgohen institucionit kompetent të Palës Kontraktuese shtetas i sëcilës ka qenë trashëgimlënësi, ose në vëndin e sëcilës duhet të bëhen veprime në lidhje me trashëgiminë.

Neni 41.

Masat për ruajtjen e trashëgimit

1/ Institucionet e njerës Palë Kontraktuese janë të detyruar të marrin, në përputhje me legjislacionin e tyre, masat e nevojëshme për ruajtjen ose administrimin e pasurisë trashëgimore të lënë në shtetin e tyre nga shtetasi i Palës tjetër Kontraktuese.

2/ Përfaqësia diplomatike ose konsullore duhet të lajmërohet menjëherë për masat e marra në përputhje me pikën 1; ajo mund të marrë pjesë në zbatimin e këtyre masave. Masat e marra në përputhje me pikën 1, me kërkesën e përfaqësisë diplomatike ose konsullore, mund të ndryshohen, të revokohen ose të pezullohen.

3/ Institucioni i Palës Kontraktuese shtetas i sëcilës është trashëgimlënësi, që është kompetent në bazë të pikës 1 të nenit 37, mund të propozojë revokimin e masave të marra në përputhje me pikën 1 të sipërme.

Neni 42.

Dorëzimi i trashëgimit

1/ Kur pasuria e luejtëshme trashëgimore ose shuma e nxjer nga shitja e kësaj pasurie ose të pasurisë së paluejtëshme, pas përfundimit të procedimit trashëgimor, duhet t'u dorëzohet trashëgimtarëve që ndodhen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pasuria trashëgimore ose shuma e nxjerrë nga shitja e sajë, i dorëzohen përfaqësisë diplomatike ose konsullore të këtij shteti, kur:

a) institucioni i drejtësisë të ketë thirrur, kur një gjë e tillë parashikohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese ku ndodhet pasuria trashëgimore, kreditorët e trashëgimlënësit për të paraqitur

brënda gjashtë muajve kërkesat e tyre;

b) të gjitha tatimet dhe taksat trashëgimore sidhe të gjitha kërkesat e paraqitura të jenë paguar ose siguruar;

c) institucionet përkatëse të kenë dhënë pëlqimin, në rast nevoje, për daljen jashtë shtetit të sendeve që përbëjnë trashëgimin, ose për transferimin jashtë shtetit të shumave të nxjerra nga shitja e tyre.

Nënkapitulli V

Njohja e vendimeve dhe ekzekutimi i detyrueshëm i tyre

Neni 43.

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve me karakter jo pasuror

Vendimet e gjykatave dhe institucioneve të tutorisë dhe të kujdestarisë të njerës Palë Kontraktuese në lidhje me çështjet me karakter jo pasuror, që kanë marrë formë të prerë, pranohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pa shqyrtim të mëtejshëm, kur asnjë gjykatë ose institucion i tutorisë dhe kujdestarisë së Palës tjetër Kontraktuese nuk ka dhënë më parë ndonjë vendim për këtë çështje, i cili të ketë marrë formë të prerë, ose në qoftëse ato në bazë të kësaj Konvente nuk kanë kompetencë ekskluzive.

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve me karakter pasuror

Neni 44.

Secila nga Palët Kontraktuese njohin dhe lejojnë të ekzekutohen, në përputhje me dispozitat që vijojnë:

a) vendimet që kanë marrë formë të prerë për çështjet civile dhe familjare me karakter pasuror të dhëna në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

b) vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë të dhëna në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për çështjet penale lidhur me shpërblimin e dëmit.

Neni 45.

1/ Lejimi i ekzekutimit të detyrueshëm bëhet me kërkesë dhe hyn në kompetencën e gjykatave të Palës Kontraktuese, në territorin e sëcilës duhet të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm.

2/ Kërkesa për lejimin e ekzekutimit të detyrueshëm i paraqitet gjykatës që ka dhënë vendimin mbi çështjen në shkallë të parë. Kjo kërkesë duhet t'i dërgohet gjykatës që është kompetente për të

lejuar ekzekutimin e detyrueshëm. Kërkesa mund t'i paraqitet kësaj gjykate edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Neni 46.

1/ Kërkesës për lejimin e ekzekutimit të detyrueshëm i bashkangjiten:

a) teksti i plotë i vendimit sidhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, në qoftë se një gjë e tillë nuk del nga teksti i vetë vendimit;

b) origjinalet e dokumentave ose kopjet e vërtetuara të dokumentave nga të cilat del se personit të cilit me vendim i është ngarkuar ndonjë detyrim dhe që nuk ka marrë pjesë në gjykim i është dorëzuar në kohë dhe në formën e duhur qoftë edhe një herë, njoftimi për thirrjen në gjykatë;

c) përkthimi i vërtetuar i kërkesës dhe i dokumentave që përmenden në pikat "a" dhe "b" të këtij neni.

2/ Bashkë me kërkesën për lejimin e ekzekutimit të detyrueshëm mund të bëhet dhe kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm.

Neni 47.

1/ Mënyra e dhënies së lejes për ekzekutim të detyrueshëm dhe mënyra e ekzekutimit të detyrueshëm përcaktohen nga legjislativi i Palës Kontraktuese, në teritorin e sëcilës duhet të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm.

2/ Kundërshtimet lidhur me lejimin e ekzekutimit të detyrueshëm zgjidhen nga gjykata që jep lejen, kurse kundërshtimet lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm zgjidhen nga gjykata në teritorin e sëcilës bëhet ekzekutimi i detyrueshëm.

Neni 48.

Refuzimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Njohja e vendimit ose lejimi i ekzekutimit të detyrueshëm mund të refuzohet:

a) në qoftë se personi i detyruar me vendim nuk ka marrë pjesë në gjykimin për shkak se atij ose përfaqësuesit të tij nuk i qe bërë me kohë, qoftë edhe një herë, dhe në formën e duhur, thirrja për në gjykatë, ose për shkak se thirrja ishte bërë vetëm me anë shpalljeje publike;

b) në qoftë se vendimi gjyqësor është në kundërshtim me një vendim të mëparëshëm, që ka marrë formë të prerë, të dhënë për çështjen

midis po atyre palëve, për po atë objekt dhe për po atë shkak nga gjykata e Palës Kontraktuese në teritorin e sëcilës duhet të njihet vendimi ose të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm. Kjo dispozitë nuk shtrihet për rastet kur kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore rrethanat, në bazë të të cilave janë përcaktuar nga vendimi i mëparëshëm gjyqësor përmbajtja dhe koha e ekzekutimit.

Neni 49.

Pajtimi

Dispozitat e neneve 43 - 48 zbatohen respektivisht edhe për marrëveshjet e pajtimit të bëra nga institucionet e drejtësisë.

Neni 50.

Vendimet e mëparëshme

Dispozitat e neneve 43 - 48 zbatohen edhe kundrejt vendimeve të dhëna nga institucionet e drejtësisë para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

Ekzekutimi i vendimeve mbi pagimin e shpenzimeve gjyqësore

Neni 51.

1/ Në qoftëse palës që ka qenë e shkarkuar nga sigurimi i shpenzimeve gjyqësore në përputhje me nenin 17 të kësaj Konvente i u ngarkua detyrimi të paguajë shpenzime gjyqësore palës tjetër, gjykata përkatëse në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese me kërkesë pa taksa, lejon nxjerrjen e detyrueshme të këtyre shpenzimeve.

2/ Në shpenzimet gjyqësore përfshihen gjithashtu edhe shpenzimet për lëshimin e vërtetimeve, për përkthimet dhe vërtetimin e dokumentave që përmenden në nenin 52 Nr.2 dhe në nenin 53 Nr.2 vijuese.

Neni 52.

1/ Gjykata që lejon ekzekutimin e detyrueshëm për nxjerrjen e shpenzimeve gjyqësore kufizohet në verifikimin nëse vendimi ka marrë formë të prerë dhe nëse ai duhet të ekzekutohet.

2/ Kërkesës për lejimin e nxjerrjes së detyrueshme të shpenzimeve gjyqësore i bashkëngjitet kopja e vërtetuar e vendimit mbi shpenzimet dhe një vërtetim se vendimi ka marrë formë të prerë, sidhe përkthimi i vërtetuar i këtyre dokumentave.

Neni 53.

1/ Përsa i përket nxjerrjes së shpenzimeve gjyqësore jo të paguara, gjykata e Palës Kontraktuese në teritorin e sëcilës u paraqit kërkesa për pagimin e shpenzimeve, i drejtohet me kërkesë gjykatës

kompetente të Palës tjetër Kontraktuese për nxjerrjen e shpenzimeve gjyqësore. Kjo e fundit nxjerr shpenzimet dhe i dërgon shumën e nxjerrë përfaqësisë diplomatike ose konsullore të Palës tjetër Kontraktuese.

2/ Kërkesës i bashkëngjiten: llogarija e shpenzimeve sipas vendimit, shënimi se vendimi, në bazë të të cilit kryhet ekzekutimi, ka marrë formë të prerë dhe përkthimet e vërtetuara të këtyre dokumentave.

Neni 54.

Dorëzimi i sendeve

Në rastin e ekzekutimit të detyrueshëm dorëzimi i sendeve dhe i të hollave shtetasve që banojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, bëhet në përputhje me dispozitat që janë në fuqi brënda shtetit mbi eksportimin e sendeve ose mbi transferimin e shumave të të hollave.

Neni 55.

Shpenzimet që rrjedhin nga ekzekutimi i detyrueshëm Kundrejt shpenzimeve të ekzekutimit të detyrueshëm zbatohet legjislacioni i Palës Kontraktuese në territorin e sëcilës kryhet ekzekutimi i detyrueshëm.

KAPITULLI II.

Ndihma juridike në çështjet penale

Neni 56.

Detyrim për dorëzim

1/ Palët Kontraktuese, në përputhje me këtë Konventë, në bazë të kërkesës, i dorëzojnë njera tjetrës personat që ndodhen në territorin e tyre kundër të cilëve duhet të fillojë ndjekja penale, gjyqimi, ose duhet të ekzekutohet ndonjë vendim penal.

2/ Dorëzimi bëhet vetëm për ato krime të cilat, në përputhje me legjislacionin e të dy Palëve Kontraktuese, janë të dënueshme dhe për kryerjen e të cilave ligja parashikon dënim me heqje të lirisë për më shumë se një vit, ose një dënim më të rëndë dhe për ekzekutimin e një vendimi penal me dënime të tilla (që më tutje do të quhen "krime që shkaktojnë dorëzimin").

Neni 57.

Refuzimi i dorëzimit

Dorëzimi nuk mund të bëhet:

a) kur personi, dorëzimi i të cilit kërkohet, është shtetas i Palës Kontraktuese, se cilës i është drejtuar kërkesa;

b) kur krimi është kryer në teritorin e Palës Kontraktuese se cilës i është drejtuar kërkesa;

ç) kur ndjekja penale ose ekzekutimi i vendimit, në bazë të legjislacionit të Palës Kontraktuese, se cilës i është drejtuar kërkesa, nuk lejohet për arsye të kalimit të afatit të parashkrimit, ose për arsye të dispozitave të tjera ligjore;

ç) kur kundrejt personit, që ka kryer krimin, është dhënë vendim po për të njejtin krim ose është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose nga organi tjetër i Palës Kontraktuese, se cilës i është drejtuar kërkesa;

d) kur krimi në përputhje me legjislacionin e të dy palëve kontraktuese, ndiqet mbi kërkesën e të dëmtuarit.

Neni 58.

Detyrimi për të filluar ndjekjen penale

1/ Secila Palë Kontraktuese, me kërkesën e Palës tjetër Kontraktuese, detyrohet të fillojë, në përputhje me legjislacionin e saj, ndjekjen penale kundër shtetasve të saj në qoftë se këta të fundit kanë kryer në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese krimin që shkakton dorëzimin.

2/ Kërkesës i bashkëngjiten të gjitha njoftimet mbi krimin dhe mbi provat që disponohen në lidhje me krimin e kryer.

3/ Pala Kontraktuese, se cilës i është drejtuar kërkesa, detyrohet të njoftojë Palën Kontraktuese, që ka bërë kërkesën mbi rezultatet e ndjekjes penale.

Kur për këtë çështje është dhënë vendim që ka marrë formë të prerë, kopja e tij duhet t'i bashkëngjitet lajmërimit.

Neni 59.

Mënyra e komunikimit

Për çështjet e dorëzimit të personave dhe fillimit të ndjekjes penale, meren vesh drejtpërdrejt Ministrat e drejtësisë dhe Prokurorat e përgjithëshëm të Palëve Kontraktuese.

Neni 60.

Dokumentat që i bashkëngjiten kërkesës për dorëzim

1/ Kërkesës për dorëzim duhet ti bashkëngjiten:

a) përsa i përket kërkesës për dorëzimin me qëllim ekzekutim

të vendimit, kopja zyrtare e vendimit me vërtetimin se ka marrë formën e prerë;

b) përsa u përket kërkesave të tjera, kopja e vërtetuar e vendimit për arësim, dhe përshkrimi i krimit me shpjegimin e rrethave të çështjes dhe tekstet e ligjeve, në bazë të të cilëve cilësohet krimi, Në qoftë se krimi ka shkaktuar dëm material, në këtë përshkrim shënohen gjithashtu edhe përpjestimet e dëmit që është shkaktuar nga krimi.

2/ Kërkesës për dorëzim duhet mundësisht ti bashkangjitet: përshkrimi i karakteristikave të jashtëme të personit, dorëzimi i të cilit kërkohet, të dhënat biografike mbi atë, shtetësia dhe vendqëndrimi, si dhe fotografia dhe shenjat e gishterinjeve të tij.

Neni 61.

Njoftime plotësuese

1/ Kur ka dyshim në lidhje me kryerjen e krimit ose kërkesa për dorëzimin, nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për zgjidhjen e çështjes së dorëzimit, Pala Kontraktuese, se cilës i është drejtuar kërkesa, mund të kërkojë njoftime plotësuese duke caktuar për këtë një afat prej dy muajsh. Ky afat me kërkesë mund të zgjatet.

2/ Kur Pala Kontraktuese, që ka paraqitur kërkesën, nuk paraqit njoftimet e nevojshme plotësuese, brënda afatit të caktuar, shteti të cilit i drejtohet kërkesa mund të lirojë nga arrestimi personin që kërkohet për dorëzim.

Arestimi i personit që duhet të dorëzohet

Neni 62.

Me marrjen e kërkesës për dorëzim, Pala Kontraktuese së cilës i është drejtuar kërkesa, duhet të marrë menjëherë masat për arrestimin e personit, që kërkohet për dorëzim.

Neni 63.

1/ Personi mund të arrestohet edhe para marrjes së kërkesës për dorëzim, kur arrestimi i tij kërkohet nga njera prej Palëve Kontraktuese, për shkak se ka vendim për arrestimin e këtij personi, ose vendim që ka marrë formë të prerë, me kusht që të jetë bërë lajmërimi se kërkesa për dorëzim do të paraqitet më vonë. Kërkesa për arrestim mund të bëhet nga institucionet kompetente me anë të postës, telegrafit telefonit, ose të radios.

2/ Personi mund të arestohet edhe pa marjen e kërkesës së parashikuar në pikën 1 kur ka prova të mjaftueshme se ai ka kryer në teritorin e Palës tjetër Kontraktuese krimin që shkakton dorëzimin.

3/ Në rastet e arestimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, duhet të njoftohet menjëherë Pala tjetër Kontraktuese.

Neni 64.

Personi i arestuar në përputhje me nenin 63, mund të lirohet në qoftë se brënda një muaji nga dita e nisjes së lajmërimit për arestimin nuk do të paraqitet kërkesa për dorëzim.

Neni 65.

Shtytja e dorëzimit

Kur personi, që kërkohet për dorëzim, është marë, nga institucionet e drejtësisë së Palës tjetër Kontraktuese, në përgjegjësi penale, ose është dënuar për kryerjen e një krimi tjetër, dorëzimi i tij mund të shtyhet gjer në pushimin e çështjes, ose gjersa të ketë vuajtur dënimin ose gjersa të lirohet para kohe nga vuajtja e dënimit.

Neni 66.

Dorëzimi i përkohëshëm

1/ Në rastet e parashikuara në nenin 65, me kërkesë, mund të bëhet dorëzimi përkohësisht në qoftë se shtytja e dorëzimit do të shkaktonte kalimin e afatit të parashkrimit ose do t'i shkaktonte dëm të madh hetimit të çështjes penale.

2/ Personi i dorëzuar përkohësisht, duhet të kthehet pas kryerjes së atij veprimi në lidhje me ndjekjen penale për të cilin ai u dorëzua.

Neni 67.

Kërkesat për dorëzim nga shumë shtete

Kur kërkesat për dorëzim bëhen nga disa shtete, Pala Kontraktuese, se cilës i drejtohen këto kërkesa, vendos se cila nga këto duhet të pranohet.

Neni 68.

Kufitë e ndjekjes penale kundra personit të dorëzuar

1/ Pa pëlqimin e Palës Kontraktuese, se cilës i është drejtuar kërkesa, personi i dorëzuar nuk mund të meret në përgjegjësi penale, të denohet ose ti dorëzohet një shteti të tretë, për një krim të kryer para dorëzimit, për të cilin ai nuk u dorëzua.

2/ Nuk kërkohet pëlqimi i permendur në pikën 1 në qoftë se personi i dorëzuar dhe që nuk është shtetas i Palës Kontraktuese në teritorin e së cilës ai gjëndet, mbas pushimit të çështjes penale, në rast denimi, pas vuajtjes së denimit, ose pas përjashtimit nga vuajtja e denimit, brënda një muaji nuk largohet nga teritori i Palës Kontraktuese, që ka paraqitur kërkesën, ose kthehet përsëri. Në këtë afat nuk llogaritet koha, gjatë së cilës personi, jo për faj të tij, nuk ka mundur të largohet nga teritori i Palës Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën.

Neni 69.

Dorëzimi

Pala Kontraktuese, se cilës i është drejtuar kërkesa, detyrohet ta njoftojë Palën Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën për vendin dhe kohën e dorëzimit. Në qoftë se Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesë nuk e mer në dorëzim personin e kërkuar brënda një muaji pas datës së caktuar për dorëzim, ky person mund të lirohet nga arrestimi.

Neni 70.

Dorëzimi rishtas

Në qoftë se personi i dorëzuar u shmanget ndjekjeve penale ose vuajtjes së dënimit dhe kthehet në teritorin e Palës Kontraktuese, së cilës i është drejtuar kërkesa, atëhere me kërkesë, ai duhet të arrestohet dhe të dorëzohet pa u paraqitur dokumentat që përmenden në nenet 60 dhe 61.

Neni 71.

Njoftimi i përfundimit të procedimit

Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën duhet të njoftojë Palën Kontraktuese se cilës i është drejtuar kërkesa mbi përfundimin e procedimit penale kundër personit të dorëzuar. Në qoftë se kundër personit është dhënë vendim dhe ky ka marrë formë të prerë, duhet të dërgohet kopja e tij.

Neni 72.

Kalimi tranzit i personave që kanë kryer krim

1/ Secila nga Palët Kontraktuese, me kërkesë duhet të lejojë kalimin në teritorin e sajë të personave që i dorëzohen Palës tjetër Kontraktuese nga një shtet i tretë.

2/ Kërkesa, simbas pikës 1, përpillohet dhe paraqitet po në atë mënyrë si edhe kërkesa për dorëzim.

3/ Palët Kontraktuese nuk janë të detyruara të lejojnë kalimin e personave në qoftë se dispozitat e kësaj Konvente nuk parashi-kojnë dorëzimin.

Neni 73.

Dorëzimi përkohësisht i personave të arrestuar

1/ Kur lind nevoja për të pyetur si dëshmitarë persona që mbahen të arrestuar në teritorin e Palës Kontraktuese, sëcilës i është drejtuar kërkesa, organet e Palës Kontraktuese që përmenden në nenin 59 mund të urdhërojnë sjelljen e tyre në teritorin e Palës Kontraktuese që ka bërë kërkesën me kusht që ata të mbahen të arrestuar dhe të kthehen menjëherë pas mbarimit të marrjes në pyetje.

2/ Në qoftëse lind nevoja për të pyetur si dëshmitarë persona që ndodhen të arrestuar në një shtet të tretë, organet e Palës Kontraktuese që përmenden në nenin 59 të cilëve u është drejtuar kërkesa, lejojnë kalimin e këtyre personave nëpërmjet teritorit të shtetit të tyre, duke u respektuar dispozita e nenit 9 të kësaj Konvente.

Neni 74.

Dorëzimi i sendeve

1/ Palët Kontraktuese, me kërkesë, i dorëzojnë njera tjetrës:

a) sendet dhe të hollat që janë fituar nga kryerja e një krimi që shkakton dorëzimin, duke u respektuar dispozitat në lidhje me kalimin e sendeve dhe transferimin e të hollave jashtë shtetit;

b) sendet të cilat mund të kenë rëndësinë e provave materiale në çështjen penale, edhe sikur dorëzimi i personit që ka kryer krimin nuk mund të bëhet për shkak të vdekjes së tij, aratisjes ose për shkaqe të tjera.

2/ Në qoftëse sendet që kërkohen për dorëzim, janë të nevojshme si prova materiale në çështjen penale për institucionet e drejtësisë të Palës Kontraktuese, sëcilës i është drejtuar kërkesa, dorëzimi i tyre mund të shtyhet gjer në përfundimin e çështjes.

3/ Të drejtat e personave të tretë mbi sendet që duhen dorëzuar mbeten të paprekura. Pas përfundimit të çështjes këto sende duhet t'i kthehen Palës Kontraktuese, sëcilës i është drejtuar kërkesa, për t'ia dorëzuar personit që ka të drejtë mbi to.

Neni 75.

Njoftimi mbi vendimet me dënim
Palët Kontraktuese i dërgojnë njera tjetrës njoftime mbi vendimet që kanë marrë formë të prerë, të dhëna nga gjykatat e njerës nga Palët Kontraktuese kundrejt shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese, duke marrë njëkohësisht masat që të dërgojnë edhe shenjat e gishtave të të dënuarve kur këto disponohen.

Neni 76.

Njoftime mbi dënimet e mëparëshme
Me kërkesën e gjykatave dhe prokurorive të njerës Palë Kontraktuese Pala tjetër Kontraktuese jep falas njoftime mbi dënimet e mëparëshme të personave që ndiqen në teritorin e Palës Kontraktuese që bën kërkesën.

PJESA III.

Dispozita të fundit

Neni 77.

Ratifikimi

Kjo Konventë duhet të ratifikohet. Shkëmbimi i instrumentave të ratifikimit do të bëhet në kohën më të afërtë në Bukuresht.

Neni 78.

Hyrja në fuqi

1/ Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas shkëmbimit të instrumentave të ratifikimit. Konventa do të jetë në fuqi për pesë vjet nga dita e hyrjes së sajë në fuqi.


2/ Në qoftëse brënda gjashtë muajve para mbarimit të afatit të sajë asnjëra nga Palët Kontraktuese nuk do të denoncojë këtë Konventë, kjo mbetet në fuqi çdo herë edhe për pesë vjet të tjera.

Kjo Konventë u përpillua në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe rumune dhe të dy tekstet kanë fuqi të njëjtë.

Për vërtetim sa më sipër, të plotfuqishmit e të dy Palëve Kontraktuese, nënshkruan këtë Konventë dhe vunë vulat e tyre.

Bërë në Tiranë me 12 shtator 1960.

ME AUTORIZIM TË PRESIDIUMIT TË
KUVËNDIT POPULLOR TË
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
RIZA TAUSHANI



ME AUTORIZIM TË PRESIDIUMIT
DHE ASAMBLESË SË MADHE KOMBË-
TARE TE REPUBLIKËS POPULLORE
RUMUNE
GJEORGJE VELLÇESKU

